

Arbër AHMETAJ

*Një natë tek Luiza*

RL Books, Bruxelles, 2024



**Arbër AHMETAJ**  
*Një natë tek Luiza*

Roman, 182 Seiten / pages / pagine  
Bruxelles, RL Books, 2024  
€ 15.00  
ISBN 978-9928-4241-9-8  
[www.rlbooks.eu](http://www.rlbooks.eu)

**Inhaltsübersicht / Bref résumé / Breve riassunto**

Das Buch beginnt in Albanien in der Zeit des Kommunismus. Die Hauptfigur, ein kleiner Junge, soll für seinen Bruder eine Liebesbotschaft an dessen Schwarm übergeben. Voller eigener Sehnsucht nach der Frau reicht er ihr einen Brief. Kurz darauf flieht er aus Albanien in die Freiheit.

Viele Jahre später, in einer Bar in Paris, erkennt er sie wieder. Und verbringt die Nacht bei Luiza auf dem Hotelzimmer.



Nach ihrer Vereinigung liest Luiza das Manuskript des nun als Autor tätigen Mannes. Im Buch werden die Kapitel des Manuskripts als Kurzgeschichten in Kapiteln erzählt und entführen einen immer wieder zurück in den Kommunismus Albaniens, den Geschehnissen und Gedanken und Umständen in der wohl eindrucklichsten Zeit des Balkanlandes.

**Begründung des Vorschlags / Motivation de la proposition / Motivazione della proposta**

Der Autor erzählt in seinem Roman «Eine Nacht bei Luiza» von einer Liebe, die in Albanien beginnt, durch Armut, der Angst im Schatten des Kommunismus und der Verzweiflung, auseinandergerissen wird und in der Diaspora nach vielen Jahren wieder zusammenfindet.

Zwischen der Begegnung dieser zwei Menschen und deren gemeinsamen Nacht, finden fünf Kurzgeschichten durch verschiedene Kapitel immer wieder nach Albanien zurück. Diese Geschichten sind ein wahrer Schatz an Gedanken und Traumata des Volkes, ungeheuren Umständen und einer Paranoia, die dem Volk eingeprengelt wurde. Und Geschehnissen, wie wir sie selten in der Literatur finden – auf spielerische Weise und gekonnt, mit Charme und Witz, aber auch Ehrfurcht, erzählt.

Luiza bewertet jede Kurzgeschichte und man erfährt immer mehr über die Beziehung der beiden und wie ihr Leben ohne einander verlief.

Dieses Werk wäre daher eine Bereicherung für die deutschsprachige Literatur.

**Biografie / Biographie / Biografia**

Arbër Ahmetaj, \*1965 in Tropoj (Albanien), wohnt in Sion. Er studierte Pharmazie an der Universität von Tirana. Parallel dazu verfolgte er eine Karriere als Journalist, schrieb für literarische und politische Zeitungen und arbeitete später für das albanische Staatsfernsehen und als Diplomat, bis er am Ende der 90er Jahre in die Schweiz zog. Heute arbeitet er als Apotheker in Monthey im Wallis. Er veröffentlichte mehrere Werke in albanischer Sprache, 2007 war er Co-Autor in der Erzählsammlung «Le chameau dans la neige et autres récits de migrations» (Editions d'En Bas). 2010 erschien ein Gedichtband in albanischer Sprache mit französischer Übersetzung (Verlag Mërgimi A&B).

*Quelle Biografie: <https://literaturhaus.ch/veranstaltungen/lesefest-vielsprachige-schweiz-arber-ahmetaj-albanisch-mico-m-savanovic-serbisch/>*

Arbër Ahmetaj

# Një natë te Luiza

**RL BOOKS**

2024

*Krëfim dashurie*

**L**uiza kish vënë një disk me muzikë xhaz. Prej saj mësova që ishte Bobby McFerrin dhe grupi i tij “Yellow Jackets”. Nuk e kisha dëgjuar kurrë e as më rastisi më pas asaj pasditeje. Më pëlqeu. Qe fund maji. Qielli kish marrë një të purpurt të lehtë. Një papagall plot ngjyra lëshonte herë pas here tinguj të çuditshëm. Një lloj fjalimi i pakuptueshëm, por shumë energjik. Pastaj merrej me ushqimin, pinte ujë dhe rrotullonte kokën sa andej-këndeje, në kafazin e varur në pemë. Gruaja erdhi me një shishe verë të bardhë, dy gota dhe një pjatë mollë “tentation”. Papagalli lëshoi edhe ca fraza e prapë u qetësua. Bobby këndonte, imitonte tinguj, gjallesa, fëshfërima e nganjëherë i linte vend orkestrës.

- E lexova me një frymë romanin tënd! Por, ma zuri frymën!

Luiza vinte nga Islanda. E njoha në një seancë nënshkrimesh, ku ajo shërbente verë, buzëqeshje dhe kartëvizita për pjesëmarrësit. Kishte pranuar t’i jepte një dorë librares që organizonte mbrëmjen për mua, me kusht që të mund të shpërndante kartëvizitat, ta bënte të njohur shërbimin e saj të masazhit indian. Ma dha edhe mua një, kur po i nënshkruaja romanin tim të parë, të sapobotuar në frëngjisht.

Ulur përballë saj, dy javë më vonë, nuk po dija si t'i merrja ato fjalë. Por, siç e kërkojnë rregullat e njerëzve publikë, që më është dashur t'i mësoj i detyruar nga agjenti im letrar, e falënderova për sakrificën që kishte bërë: pat vrarë pa mëshirë dy apo tri ditë të lexonte romanin tim, në vend që të fërgonte patate, të shëtiste vreshtave apo të bënte shooping... Ah shooping!

Sigurisht që nuk ia thashë. Me vete kisha marrë edhe dorëshkrimin e librit tim të fundit me tregime, sikur ta kisha parandierë se biseda rreth romanit do ia zinte frymën edhe bisedës sonë.

- Ma mori frymën, - vazhdoi ajo, - je treguar i pamëshirshëm në përqendrimin e anëve të errëta të jetës.

- Titullin në origjinal e ka "Fletëhyrje për në varr", - i thashë. - Me gjithë zbutjen në frëngjisht, libri është po ai.

- Edhe një histori dashurie që ke sjellë në atë libër, e ke futur në kurthin e një keqkuptimi me pasoja të rënda. Prisja që aty të paktën të ishe pak më i kujdesshëm me lexuesin, të cilin e torturon pa mëshirë deri në fund.

- Të kuptohemi, nuk ka qenë ky synimi im. E kam shkruar pa menduar për lexuesit; madje as që shpresoja se do botohej një ditë. Kjo mund të jetë e gabuar, por realitetin që përshkruaj në atë roman, nuk më lejohej ta zbukuroja që të mos "ia zija frymën" lexuesve!

- Tekste të tilla gjenden në letërsinë e shumë popujve. Irlandezët, për shembull, edhe pse nuk e përmendin, e kanë trajtuar çështjen e mungesës së lirisë në shumë romane. Jo vetëm atë që ua kishin marrë britanikët, por, në të njëjtin shtresëzim simbolik, sjellin shtypjen e lirive nga ana e autoritetit të kishës. Komitetet e partisë apo institucionet e shërbimeve sekrete në vendet tuaja nuk ndryshojnë shumë prej fuqisë satanike të kishës, jo veç asaj katolike apo institucioneve të ngjashme në fe të tjera. Priftërinjtë kanë pasur në dorë jetën tuaj mbi dhë, në qiell apo parajsë, por kanë pasur të drejtë edhe mbi trupin e shpirtin tuaj. Ata kishin në dorë emocionet, dashuritë, deri edhe bukën e gojës së subjekteve të tyre. Dhe e kanë ushtruar atë pushtet me përpikëri frymëzënëse.

- Ndoshta, - ia ndërpreva fjalën, - por për njerëz si unë, që kanë jetuar në vende ateiste, kjo lloj shtypjeje nuk kuptohet. Ne na “çliruan” nga këto gjëra për të na i marrë të gjitha, edhe të drejtën për të besuar e për t’u lutur në fshehtësi. Pastaj, edhe sot e kësaj dite na duket se, njerëzit që flasin kështu, janë shejtanë të bolshevizmit ose pjellë e keqe e revolucionit francez.

Vuri buzën në gaz me këtë bashkërenditje të shejtanëve e pjellave të këqija të revolucionit. Nxori shishen nga një kovë e argjendtë me akull dhe mbushi gotat. I ngritëm dhe uruam në anglisht “Cheers!”. Më pyeti se si thuhej në shqip kjo fjalë. U përpoq ta shqiptonte, por nuk ia arriti dot dhe qeshi. Flokët e



verdhë iu drodhën si rrezet e diellit në një pellg uji të trazuar.

- Kam studiuar për letërsi në Rejkjavik dhe Dublin. Pastaj ndoqa ëndrrën time për t'u bërë aktore në Londër. Aty, things went wrong, drugs and so on ! Jam kuruar për dy vjet në një klinikë dezintoksikimi në Gjenevë. Aty mësova edhe frëngjisht.

- Gjëra që ndodhin. Më vjen mirë që kjo i përket së kaluarës! "Jetojmë në tokë, s'ka kurë që na shpëton nga kjo ndotje!", në mos gabohem, shkruan në mbyllje të një drame Samuel Beketi.

Si të qe i një mendjeje me fjalët e dramaturgut, papagalli lëshoi disa tinguj të gëzueshëm. Qeshëm. Pas pak çasteve mendova se biseda kishte marrë për keq. Kisha vite që u ruhësja përzierjeve të tilla. Nuk e njihnim njëri-tjetrin sa për të folur për drugs and so on. Megjithatë, më erdhi mirë që ajo, sinqerisht dhe shpejt e shpejt, foli për atë problem të së kaluarës së saj, si për të mos më lënë me iluzione. Qe një qenie njerëzore me gjithë hipotekën e përvojave, arritjeve dhe dështimeve të veta. Atëherë kur po mendoja se nuk do fliste më për të shkuarën e saj, por do t'i rikthehej romanit tim, duke pulitur sytë, më tha:

- My London experience vrau tek unë thelbin e të qenit njeri, aftësinë për të dashuruar. Pozova si modele për dy-tri faqe me ngjyra të një reviste mode. M'u duk vetja se kisha arritur majat e suksesit. Më ofruan role në filma pornografikë dhe nga pak pluhur të bardhë. Pas kësaj, i dashuri im, një indian

i ardhur në Dublin, për të studiuar mbi Xhojsin, iku në Pakistan, pasi avioni kushtonte më lirë sesa për New Delhi. Aty e arrestuan dhe e dërguan në burgun e Abu-Grabit. Vdiq nga torturat. Letrën e tij të fundit e mbyllte kështu: “Po ma marrin shpirtin, veç një gjë s’ma marrin dot: dashurinë për ty!”. Ajo letër më nxori nga droga!

Gjëja që doja t’i shmangesha më së shumti asaj pasditeje që pikërisht ajo që po ndodhte. Një grua e panjohur po më tregonte historinë e saj, ndoshta me shpresën se ndonjë ditë do shkruaja për të. Më kishte ndodhur shpesh një gjë e tillë dhe gjithmonë më linte një shije të keqe. Papagalli i shpeshtoi ndërhyrjet. U bë i bezdisshëm. Dielli po i afrohej perëndimit, ndërsa vera po më ngrohej në gotë. Ajo hodhi prapë. Deshi të ma mbushte edhe mua. Kundërshtova me delikatesë, por nguli këmbë. U ngrit dhe u kthye me një libër në dorë. Pa mundur ta shihja titullin dhe autorin, ajo e hapi diku dhe lexoi ca vargje:

*J’ai la fureur d’aimer.  
Mon coeur si faible est fou  
N’importe quand,  
n’importe quel et n’importe où!*

*S’jam i qetë pa bërë dashuri.  
E dobëta zemër u çmend  
S’ka rëndësi kur,  
me kë e në cilin vend! - i përktheva shpejt e shpejt me*

mendje.

- Kështu shkruante Pol Verleni, që s'mund të imagjinohet pa dashuritë e tij të stuhishme, - tha duke mbyllur librin "Cent poèmes de Paul Verlaine" .

Intelektualët që jetojnë rreth e rrotull meje, të cilët për fat nuk shkruajnë tregime, as romane, por kanë vetëm ide të mëdha, më thonë shpesh se letërsia e madhe është rezultat i dashurive të mëdha dhe më përmendin Homerin, Danten, Shekspirin, Tolstoin, Markezin, Coelhion...!

"Floberi ka thënë: 'Je suis Madame Bovarie!'" , më tha njëherë im bir, që është bash në moshën e tërmeteve hormonale me lëkundje të larta. Një bombë h me dy këmbë, me trup e pamje atleti. Kështu po bënte edhe Luiza. A thua ata e ndjenin se në librat e mi nuk flitej edhe aq për dashurinë? Apo ishin këshilla dylekëshe, sa për të bërë të diturin?

Letërsia, si dashuria, më mbrojnë nga ambiciet e kohës, nga vaniteti i të qenit dikushi, nga ëndrrat për t'u bërë i pasur dhe ndikues. Të dyja, edhe letërsia edhe dashuria, përbëjnë për mua kurën mbrojtëse më të sigurt ndaj tërheqjeve të tilla universale. Ato më kanë mbajtur e më mbajnë të lidhur me veten, me thelbin e thjeshtë e të mrekullueshëm të të qenit njeri. Dikur kishte me tepri njerëz që më tallnin, që më vlerësonin si jashtë kohe: kjo më kënaqte, më jepte siguri. Dashuria dhe letërsia ia kishin arritur qëllimit. Më kishin ruajtur nga ajo murtajë gëlltitëse, që vërtitej rreth e rrotull.

U ngrita. Në hyrje të sallonit pata lënë kopjen e shtypur të disa tregimeve. Botuesi dhe agjenti letrar më kishin këshilluar që të botoja diçka më ndryshe sesa romanet e mia, diçka më të butë, më të ëmbël. T'i shmangesha me çdo kusht cilësimit si shkrimtar i ashpër, i errët, i palexueshëm apo i vështirë! Po çfarë shkrimtari isha në të vërtetë? A ia vlente të krahasohesha? Po të isha si ky ose si ai, çfarë vlere do kishte të shtohesha edhe unë? Të kishim edhe një shkrimtar më tepër? Atdheu po bëhej gazi i botës. S'kishte familje që s'kishte një ose dy shkrimtarë. T'i pyesje të rinjtë në rrugë se çfarë donin të bëheshin, kryeministër, së pari të përgjigjeshin, së dyti, shkrimtar! Shqipëria e ngratë e sapoçliruar nga komunistët, u sulmua në befasi nga hordhia e shkrimtarëve. U gjet e përgjumur. U pushtua. Në atë shkërdhnajë shkrimtarësh, vështirë të shquheshe, të fitoje besim në vetvete. Prej askujt s'mund të prisje singeritet, të të thoshte haptas: shqyeje atë dorëshkrim, ndiz zjarr me të! Fshij bythën me të. Ja pse një pjesë e madhe e autorëve, me paratë dhe ndihmat e kushërinjve të mërguar, lypën e gjetën përkthyes për veprat e tyre dhe u dhanë punë shtypshkronjave në Evropë, për të printuar kryeveprat e tyre të pakuptuara në gjuhën amtare. Ja pse edhe unë kisha përkthyer “mjeshhtërisht” disa nga tekstet e mia dhe doja të dija mendimin e një lexueseje të huaj. Për romanin e parë kisha marrë disa vlerësime, përdredhje buzësh dhe komplimente nga njerëz që e kishin lexuar librin e një autori të

huaj, të kuptonin se me kë ishin fqinj. Gazeta lokale botoi një bisedë me mua, që u bë shkak të më ftonin në shoqatën e shkrimtarëve, të më thërriste drejtori i bibliotekës e të më propozonte që nga gjithçka që botoja, të ruaja dy kopje për bibliotekën e qytetit, pasi, tashmë, isha autor nga qyteti i tyre. Lexuesja e huaj, për fatin tim, ishte një studiuese e letërsisë, e rënë sigurisht nga vakti për shkak të “përvojës londineze”, por studimet e saj qenë efektive dhe sapo kishte nisur përpjekjet për të dhënë mësim anglisht dhe letërsinë e asaj gjuhe në kolegjin privat “Kurt Bosch”.

Luiza ndërkohë i qe përgjigjur disa telefonatave dhe po merrej në brendësi të apartamentit me disa çikërrima. Dikur erdhi dhe u ul përballë meje.

Ia zgjata. “H-bombë” qe titulli. Isha i sigurt që botuesi nuk do ta pranonte, edhe pse h ishte për “hormonale”.

Ajo më dha librin e Verlenit. U zhytëm të dy në lexim. Papagalli humbi në mendime ose fjeti gjumë. Nuk ia ndjeva më zërin. Gjë që më gëzoi jo pak. Teksti i parë që po lexonte Luiza, titullohej:

### **Fqinja jonë përvëluese**

Gjithçka u dogj. U bë vapë e tmerrshme. Brenda meje u ndez një zjarr, që s'dija si ta shuaja, nuk dija si të sillesha me të, një zjarrmi që më linte pa gjumë, më mbante gjithë ditën e lume në këmbë, duke u endur sa në një qosh në tjetrin. Librat që kisha në shtëpi,

nuk më jepnin asnjë të dhënë, asnjë informacion. Në bibliotekën e qytetit s'guxoja të kërkoja të tillë. Qe e ndaluar, jo veç për moshën time, për të gjithë. Shalëgjata e bibliotekës thoshte se një ndalim i tillë ishte bërë për të mirën e shëndetit tonë moral! I gjithë qyteti ishte i moralshëm, askush s'lexonte asi librash. Shkak i atij përvëlimi tërësor qe Lina J. Ajo banonte në katin poshtë nesh. Kjo ishte e mjaftueshme për ta njëjtësuar atë me gjuhët e flakës, që do përfshinin gjithë familjen tonë ushtarake.

Jemi katër vëllezër. Tre të mëdhenjtë kanë veç nga një vit e pak në mes, ndërsa unë, më i vogli, diferencohem me disa me atë që ndodhet para meje. Vëllai i madh, asokohe, kishte mbaruar ushtrinë, kish krijuar familje dhe banonte diku në anën tjetër të qytetit. Vëllai i dytë, "i madhi" që kishte mbetur në shtëpi, qe më i keqi, më rrugaçi. Mirëpo ky rrugaç ishte fort i hijshëm, villak i gjatë e truplidhur, me sy jeshil të mëdhenj, në një fytyrë të bardhë e të imtë, të skalitur me shumë kujdes. Kishte flokë të zinj, të gjatë, më të gjatë se ne të tjerët, të rëndë dhe të hijshëm, të larë dhe vezullues. Ai që kam para vetes, qe tip shkencëtari a shkrimtari, nuk e di. As që merrej vesh ç'qe. Përgatitej për studime të larta, herë në teatër, herë në kimi, herë në letërsi. Ajo që dinim saktësisht, ishte se ai s'bënte pjesë më në familjen tonë, jetonte me avujt e librave, me ethet e mësimit.

Sapo kisha mbaruar klasën e tetë. Kishte filluar të më dukej vetja i rritur. Jo aq sa të guxoja të kundërshtoja

“urdhrrat” e vëllait të madh, por jo edhe aq i vogël sa të mos guxoja t’i bëja hile. Por zjarri shtëpisë sonë nuk i hyri për shkakun tim, por prej fqinjës sonë.

Ajo, fqinja jonë përvëluese, që nja dy-tre vjet më e madhe se unë. E sikur të mos mjaftonte kjo, unë qeshë edhe me shtat tmerrësisht më i vogël se ajo. Mezi i arrija tek supi, por edhe për nga të tjerat, nuk i bija as në zog të këmbës, në atë zog këmbë që dukej sikur cicëronte sipër sandaleve të lastikta. Dy herë, duke u varur sipër ballkonit, kisha arritur të shihja pothuajse një të tretën e gjinjve të saj të trëndafilte, dy gjysmëtoptha rozë të harkuar magjishëm, që i imagjinova me nga një luleshtrydhe të zjarrtë në majë. Kaq mjaftoi që në fund të kraharorit të ndjeja një përvëlim të pandërprerë, një si rrëshqitje të vazhdueshme që më mundonte, më bënte të harroja urinë, etjen, lodhjen dhe të gjitha hallet e deriatëhershme.

Ajo që plotësisht e ndërgegjishte për pasuritë e saj, ndaj luante me to me shumë kujdes, aq sa për të shtuar lakminë e të tjerëve, por jo për t’i vënë në rrezik. E donte veten më shumë se të tjerët, donte bukuritë që mbarte dhe nuk kujdesej për ato të të tjerëve. Nuk kishte ndërmend të shkëmbente gjë, as të ndante gjë; i mjaftonte vetvetja. I mjaftonin sytë e kaltër, me të cilët mund të shihte gjithçka. Pse thonë se sytë e bukur shohin vetëm gjëra të bukura? Unë s’kam sy të bukur, të paktën jo aq sa të përfitonin të drejtën të shihnin atë. Gishtat e bardhë e pak të

tultë, me qukëza të vogla nëpër nyje, i përfundonin me thonj të hollë, krejt ngjyrë rozë, aty-këtu me pika të bardha - shenjëza fati. Kyçin e dorës e kish një mekanizëm shumë delikat; lëkura e tejdukshme zbulonte në anën e poshtme gjithë enët e gjakut, madje të krijohej përshtypja se mund të hetoheshin dhe nervat, deri edhe lëngu sinovial që lëmonte kokcat. Këtë tejpushmëri, lëkura e saj e ruante pothuajse në të gjitha pjesët e tjera të trupit - ato pjesë që mund të shiheshin normalisht dhe ato që i zbulonte nga “pakujdesia”.

Një tru i parehatshëm si ai imi shkonte edhe më larg: “shikonte” deri në thellësi të rrobave, poshtë tyre, pikërisht aty ku trupi njerëzor mbulohet më shumë se gjithkund, përveç veshjes së jashtme, edhe me një palë veshje të brendshme, në fund të fundit, edhe me një veshje natyrore, leshtore, aq ndjellëse e provokuese. Në atë leshnajë të imshtë mbi kodër, humbte pafundësisht rrugën imagjinata ime, për t’u mbytur në thellësinë përvëluese.

Rrija ulur në ballkon për orë të tëra dhe dielli mbrëmësor më përbironte ndër pore, derisa shkrehesha. I tejloður dhe shpresëhumbur në do mund ta shihja prapë, kur errësohej krejtësisht, hyja brenda si një greminë. Shtrirë mbi shtratin e fortë, përpiqesha të hidhja ndonjë varg në fletoren e trashë të vjershave. Një gjumë i lëngësht më rridhte nëpër këmbë e më duhej të ndërrohesh dy-tri herë gjatë natës. Ky përvëlim i ëmbël, djallëzor dhe i



mundimshëm njëkohësisht, më treti gjatë fillimit të verës.

Një mbrëmje, tek po kthehesha prej shëtijes së vonë, vëreja poshtë ballkoneve dy hije. Nga lëvizja e kokës dhe leshrat e shumta, hetova se njëri ishte im vëlla, “i madhi”. Po tjetri, apo tjetra? Po sikur të qe ajo? Ditët që vijuan, u përshkuan nga përpjekje të ethshme për të zbuluar të vërtetën.

Ndërkohë, vëllai dukej se nuk zhytej fort në cektësinë e shqetësimeve të mia. Ai e dinte që unë vuaja, por sillej sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Më lutej shpesh të dilja e të shëtisja atyre ditëve të bukura vere (që ai ta kishte shtëpinë bosh!). “Na, leshtë, në shtëpi do të rri!”, betohesha me vete. Ndërkohë, vëllai tjetër, që mësonte në dhomën e tij, nuk e pengonte; sikur të mos ishte fare. Unë isha problemi dhe do vazhdoja të isha.

Gjithçka u përmbys një mëngjes, kur vëllai i madh më thirri në hapësirën e tij të dhomës, në atë që quhej mbretëria e gangsterëve, e garipave - bota e të rriturve!

- Kam një mision për ty! - më tha me një ton teatral.

- Gjithmonë gati! - thashë unë, duke ngritur grushtin te balli.

Ai qeshi e ma hodhi dorën në qafë miqësisht. Ishte hera e parë që po krijonim një marrëdhënie të tillë.

- Dëgjo, - më tha, - e di që ti nuk më do, por mes të rriturve ka rregulla, ka marrëveshje, ka fjalë burrash. Tani ke mundësi të dëshmosh se je pjekur, je bërë i

denjë për të hyrë në shoqërinë e të rriturve!

O Zot, çfarë nuk do jepja të hyja në atë botë, të shkoja me të atje ku ai shkonte me shokët, të dëgjoja bisedat e tyre, të isha njëri prej tyre, të më ndodhnin edhe mua ato që u ndodhnin atyre. Le të paguhej kjo edhe me çmimin e zënkave me babanë, e flakareshave dhe zemërimit të tij të papërmbajtur. Mirëpo, e gjitha kjo dukej e largët, e pamundshme, sepse vëllai im nuk synonte të më përfshinte në botën e tij; sigurisht që fshihte diçka djallëzore në atë propozim.

- Misioni yt i parë është dorëzimi i kësaj letre në duar të sigurta!

Kjo u ngjante dialogjeve të filmave me partizanë dhe gjermanë.

- Si urdhëron, shoku komandant: tregomë ku janë ato duar të sigurta...!

- Një kat më poshtë, në duart e Linës.

Në fillim më erdhi për të qeshur. E ndala veten në sekondën e fundit. Fill pas kësaj mezi e ndala të qarën. Pastaj desha t'ia përplasja në fytyrë, të grindesha me të, t'i tregoja se sa i pabesë dhe i lig ishte treguar, që s'kish mundur të shkonte pak më larg për të gjetur një shoqe, një mike, veç të ngatërrohej me të vetmen vajzë që ishte në fushën time të gjetisë, disa dhjetëra metra rreth e rrotull shtëpisë. Nuk thashë asgjë. Shtrëngova dhëmbët, tregova seriozitet, vetëpërmbajtje.

Do vinte dita kur ai do t'i paguante të gjitha! E mora letrën e palosur me kujdes, mbështjellë me plastmas

dhe lidhur me llastik. Ky paketim ishte bërë me qëllim që unë të mos e hapja. Disa kohë më parë, im vëlla më kishte treguar një letër dashurie që e ruante me kujdes në fund të një kutie. Më kujtohej emri i vajzës, madje e njihja edhe për fytyrë, njëfarë zeshkane, që banonte në fshatin ngjitur me qytetin tonë.

E pyeta se kur duhej ta dërgoja atë letër “në duart e sigurta” dhe më tha se do më lajmëronte shpejt. Si shpërblim për nderin që po i bëja, i kërkova të ma lexonte edhe njëherë letrën e katundares zeshkane. Ai më nxori nga dhoma, që të mos e shihja vendin ku e kishte fshehur, e më thirri prapë pas pak minutash. Nuk ma dha në dorë, por e lexoi vetë me një zë teatral të pjerdhur.

*“I dashur B.*

*Sot, kur të pashë, m’u duk sikur dielli i pranverës shkëlqente edhe më shumë, m’u duk sikur lulet lëshonin aroma edhe më të këndshme, m’u duk sikur...”*

Kështu vazhdonte letra pasionante me fjali bujqësore, që lidheshin me barin, pemët, lulet dhe dashurinë që po hapte sythe në zemrën e vajzës së fshatit.

Im vëlla bënte sikur tallej me atë letër, edhe pse e ruante me kujdes dhe e lexonte herë pas here. Në fund, mbyllej me këtë strofë:

*“Sa ka deti ujë dhe vala,  
sa ka pisha fllad dhe hala,  
yje qielli sa numëron,  
zemra ime ty të don”*

Kjo ishte poezia e vetme që vëllai kishte mësuar

përmendësh në jetën e tij. Poezi që, i detyruar ta dëgjoja shpesh, e mësova edhe unë. Bash aty m'u duk se ishte gracka, ku ai do binte si laraskë.

Të nesërmen, në një çast të qetë, aty rreth orës dhjetë të mëngjesit, më besoi dërgimin e letrës së mbështjellë me plastmas dhe llastik. Zbrita në katin e poshtëm e kërcita në derë, i bindur (sipas informacioneve të sigurta të tim vëlla, që kish vëzhguar gjithë mëngjesin hyrje-daljet në pallat) se fqinja ishte vetëm me motrën e vogël në shtëpi. Dera u hap e përpara meje u shfaq ajo, që deri atëherë nuk kisha guxuar kurrë ta shihja drejt e në sy. Me një lirshmëri të magjishme, më përshëndeti, ma shtrëngoi dorën dhe më tërhoqi brenda korridorit gjysmë të errët. Aty ia dhashë letrën e vëllait dhe, bashkë me të, një tjetër, ku kisha shkruar poezinë e katundares. Ajo i futi shpejt në xhep, më tërhoqi drejt vetes e më puthi në faqe. Instinktivisht u përpoqa t'i shkëputesha nga duart, por befas ndjeva buzët e saj, gabimisht, në qosh të të miave. Pastaj më pa në dritë të syve. Gjunjët m'u drodhën dhe zemra po ngutej të më dilte nga kraharori. Goja m'u tha deri në stomak. Dola nga apartamenti i saj, pa guxuar të ngjitesha sipër, ku duhej të më priste me ankth vëllai. Mora rrugën drejt pishnajës që përbënte kurorën e kodrinës, sipër pallateve të lagjes ku jetonim.

Në mbrëmje, përpara se të mund t'i shpjegoja tim vëllai se si kishte vajtur dorëzimi i letrës, babai na tha se të nesërmen do niseshim për në fshat, ku

do rrinim deri në fund të gushtit. Fillimisht desha ta kundërshtoja atë vendim të padrejtë, por shpejt e kuptova se qe e kotë. U tërhoqa në dhomën time, me ballkonin mbi atë të fqinjës përvëluese, dhe nisa të qaja. Sigurisht me kokë të fshehur poshtë nënkresës dhe me veshët pipëz për të dëgjuar se mos dera e ballkonit të saj hapej. Dikur, im vëlla hyri në dhomë, m'u afrua dhe më falënderoi për misionin që kisha kryer, pa më pyetur se pse nuk isha kthyer drejt e në shtëpi.

- Mos qaj, - më tha, - nuk bëhet nami, do kalojmë ditë të bukura edhe në fshat!

Të nesërmen u nisëm të dy bashkë. Gjatë rrugës u ndalëm te lumi dhe u lamë një copë herë të mirë në ujërat e kristalta. Vetëm aty më dukej sikur përvëlimes e brendshme më fashitej pak. Ato ujëra të tejpushme, të kaltra e të gjelbra, me shkumën e bardhë, që shuhej e formohej brigjeve shkëmbore, e tresnin, e shkimnin shkrumnajën time të brendshme. Dikur, vëllai më tha të vishesha dhe ta ndiqja pas.

Miqësia me të, siç merret me mend, ishte fort e zbehtë. Rrallë ndonjëherë, kur e gënjente babanë dhe i duhej mbështetja ime, ai bëhej i butë dhe i sjellshëm me mua. Në këso rastesh, kisha përfutur shpesh. Një herë i pata kërkuar t'i shihja bllokun me fotografi femrash lakuriq, që ai e kishte sajuar duke vjedhur revista të huaja mjekësore në bibliotekën e qytetit, prej rafteve të së cilës kurrë nuk e kish lexuar një libër. Jo, ai dhe libri nuk kishin asgjë të

përbashkët. Një herë tjetër i kërkova si shpërblim t'i shihja valixhen me sendet e vyera. Gjithfarë llastiqesh, dorezash boksi, madje edhe një thikë me dorezë pleksiglassi shumëngjyrësh. Në njërën anë të dorezës, poshtë një shtrese plastike të tejdukshme, kishte vënë fotografinë e një vajze, për të cilën më tha se e kishte “dashnore” dhe më premtoi që do ma prezantonte një ditë. (Vajza e katundit, që i kishte shkruar letër, edhe po të dilte në fotografi me ngjyra, dilte prapë se prapë bardhë e zi!). E dija se qe rrenë. Vajza e thikës qe fotografi me ngjyra nga ato të revistave mjekësore, ku u bëhej reklamë shampove apo barnave kundër kancerit të gjirit. Në Shqipëri, në atë kohë, asnjë vajzë, të paktën në qytetin tonë, nuk kishte fotografi me ngjyra, le më ajo e fshatit. Po edhe sikur të kishte, si do mund t'ia jepte vëllait, që ky ta balsamoste në dorezën e thikës së tij ilegale?!

Ecëm një copë herë pa folur. Uji i mbathjeve të lagura na doli sipër pantallonave, kështu që herë-herë ndërronim rrugë, për t'iu shmangur kalimtarëve të rastit. Në njërën prej këtyre dredhave të vogla, në një lëndinë të rrethuar nga një bungajë e rrallë dhe dëllinja, befaz na zunë sytë dy trupa lakuriqë. Vëllai ma vuri dorën në gojë dhe më ndali në vend. Çifti qe shtrirë mbi bar dhe po shtërzonte. Ne shihnim veç bythët e tyre cullak, që afroheshin e largoheshin ritmikisht. Qe ditë e nxehtë vere dhe djersët mbi trupa u shkëlqenin si skurrjela të arta. Tek shihja me frymë të ndalur, shtrirë përtokë rrëzë një dëllinje,

mendja më fluturoi menjëherë te fqinja ime.

Fillimisht përfytyrova se si kishte reaguaro ajo ndaj letrës së tim vëllai, pastaj ndaj poezisë së katundares dhe dy rreshtave që kisha shkruar unë, në letrën shtesë që i dhashë. I pafuqishëm të sillja para sysh fytyrën e saj, shpejt kalova në imazhe më të lehta, më të afërta për mua. M'u duk se vendin e çiftit të huaj në lëndinë e zumë unë dhe ajo. Në vend të bythëve të tyre, përfytyrova të miat, të sajat. Nuk kaluan as tri-katër minuta dhe frymëmarrja m'u shpeshtua, një prushurimë përvëluese më hipi në fytyrë dhe...!

- A u prishe, a? - më tha vëllai, që rrinte si hajdut pas një kaçubeje.

Nuk fola, veç ofshana thellë. Do kisha dhënë gjithë botën që ai të mos qe aty me mua.

Pas pak u tërhoqëm zvarrë nëpër barishten e zhuritur, derisa u larguam aq sa për të mos rënë më në sy. U ngritëm dhe morëm rishtas rrugën për në fshat. U ndalëm në kodër, ku frynte një puhizë e lehtë. Vëllai nuk la tallje pa përdorur, më tha "karuc", më tha: "Luci yt nxjerr veç shurrë, shurrë të nxehtë e ty të rre mendja se është tjetërsend". Më tha se s'kisha pikë guximi, se edhe po të doja dikë, nuk do isha i zoti t'ia thosha. Nuk do kishte ndalur së më talluri sikur mos t'ia thosha se do t'i tregoja babës për thikën dhe dorezat e boksit, për fotografitë e kurvave të revistave, do ta spiunoja që dy net më parë s'kish qenë në shtëpi deri në orën nëntë të darkës, por rrugëve me rrugaçët e tij, me Muhamet karaxhën

dhe Agron hajnin, e në fund do t'i thosha edhe për letrën e palosur, mbështjellë me plastmas dhe lidhur me llastik, që ai më kishte “detyruar” t'ia jepja fqinjës në katin e poshtëm. Ai ma futi një shuplakë pas kresë, por jo aq të rëndë sa të më bënte të qaja. Pastaj mori një ton pajtues dhe më pyeti nëse më kishte pëlqyer “filmi” që sapo kishim parë. Desha t'i kallëzoja në fakt se si më ishte dukur ai film, madje një nxitje e brendshme po më shtynte t'i tregoja edhe për “tradhtinë” që i kisha bërë, por heshta.

Nuk i fola, as ai nuk foli një copë herë, kur befas në qosh të udhës ia dha çifti që sapo kishim parë lakuriq në lëndinë. Një malësore e bukur me shami dhe një burrë me mustaqe të zeza. Burri mbante një xhaketë të zezë në qosh të krahut, ndërsa gruaja një çantë të qëndisur e të fryrë. Ai përpara, ajo dy-tri hapa mbrapa, iu ngjitën kodrës, kaluan pranë nesh, u përshëndetëm dhe vazhduam udhën. Ktheva sytë pas dhe ia ngula gruas: fustan të gjerë me lule të kafenjta, çorape të bardha deri në gju, një palë këpucë me taka gjysmë të rrafshëta, ecte si shotë pas të shoqit. Sytë e mi nuk shihnin fustanin, por bythët e saj të lakuriqta e borë të bardha, ato që kisha parë para disa minutash.

Më erdhi keq për të.

M'u duk se ajo nuk kishte dashur, por qe ai mustaqeziu që e kishte detyruar ta braktiste rrugën e të hynte në pyll, të zhvishej e t'i nënshtrohej vullnetit të tij. Pata përshtypjen se edhe vëllai po mendonte të njëjtën gjë.



- Çudi, - tha ai pas pak, - nuk e kisha besuar kurrë që edhe kooperativistëve tanë të dalluar u del koha për t'u qirë arave e livadheve!

Më erdhi për të qeshur.

Rreth mesditës arritëm në shtëpinë e gjyshit. Ai u gëzua për mua, por, me thënë të drejtën, nuk e fshehu ftohtësinë ndaj vëllait. Shkak i ftohjes mes tyre kishte qenë vizita jonë e fundit në fshat dhe unë e dija arsyen. Gjyshi dhe gjyshja jetonin në fshat vetëm me njërin prej xhaxhallarëve tanë të shumtë. Ky qe njeri i ngushtë; kishte frikë se do vdiste urie. Fshati qe i varfër, tmerrësisht i varfër. Ata kujdeseshin për kopshtin, oborrin, disa rrënjë kumbullash e disa hardhi, prej të cilave bënë raki, reçel, oshaf. Kishin edhe dhjetë-dymbëdhjetë pula.

Edhe herën e fundit kishim qenë së bashku në fshat. Vëllai zgjohej herët, merrte llastiqet dhe fshihej nëpër bar. Prej aty i gjuante pulat me gurë. Një rës ia theu këmbën dhe të nesërmen gjyshi u detyrua t'ia këpuste kokën. Gjyshja nëmte nuk e di se cilin fëmijë të fqinjëve, që në fakt ishin kushërinjtë tanë të largët. Sipas saj, ai ia kishte thyer këmbën pulës. Në të vërtetë, atë krim e kish bërë vëllai im. E mora vesh rastësisht, kur ai po bisedonte me vëllain tjetër, fshehur mes barit të thatë të ish-stallës. Lopët, në atë kohë, i kishte marrë kooperativa. Fshatarët nuk dinin t'i mbanin. Partia dhe kooperativa dinin.

Thyerja e këmbës së pulës nuk qe bërë thjesht për kënaqësi shenje, jo, por për ta detyruar xhaxhain tonë

Arbër AHMETAJ

*Një natë tek Luiza*

RL Books, Bruxelles, 2024 (Erstausgabe/première édition/prima edizione 2015, Skanderbeg Books)

Pressedossier

Dossier de presse

Materiale stampa



## Sfondi narrativ i romaneve "I huaji, ai Kosovari" dhe "Një natë te Luiza"

*Nga: Dr. Zejnepe Alili Rexhepi, Shkup*

*Gazeta "Epoka e re", Prishtinë 26 mars 2018*

Arbër Ahmetaj është shkrimtar bashkëkohor që veprën e tij e mbështet në këndvështrime të vetëdijes historike. Shkrimtari, në shtjellimin e boshtit tematik, përmes këtyre dy romaneve ngre kuadrate logjike, përmes të cilave i realizon pritshmëritë e lexuesit, përtej kënaqësisë së leximit të lirë. Ngjarjet, në veprat e Ahmetajt, ngrihen mbi norma filozofike me sensin e zbërthimit të kodeve jetësore, rrjedhave të kohës, gjendjes sociale, nëpër të cilat parakalon, jo veç individit, por e tërë shoqëria shqiptare. I ballafaquar me situata të tendosura, njeriu (kryeheroi), as krijuesi (autori) nuk resht së përshkuari këto linja të vështira mbi të cilat është i paracaktuar të lëvizë fati i individit. Në dy romanet e shkrimtarit Ahmetaj: "I huaji, ai Kosovari" dhe "Një natë te Luiza", gjejmë prurje, të realizuara përmes përshkrim-ngjarjesh në linja përpjekjesh ku shpesh të udhëheq ëndrra-onirikja.

### E pathëna e veprës

Procedimi rrëfimor i ngjarjeve dhe përjetimeve, i mbështjellë me tisin emocional të shkrimtarit, është një pergamenë historish dhe ndjenjash që shpërndajnë dhembje për të shkuarën. Romani i parë "**I huaji, ai Kosovari**", si dhe i dyti "**Një natë te Luiza**", vijnë në formë memoresh, përvojash dhe modelesh të tjera të mbamendjes së individit, gjegjësisht autorit, si dhe mbamendjes kolektive, që nuk arrin ta zhbëjë koha, as me kalimin e rëndë të viteve. Të shkruash në 2013 romanin "I huaji, ai Kosovari" dhe në 2015 "Një natë te Luiza", sigurisht nënkupton që autori s'ka qenë vazhdimisht përballë trysnisë së aktualitetit, por ngjarjet, në formë kujtimesh, të përshkruhen me qetësi e përvojë rrëfimore. Në pjesën më të madhe të tekstit përshkruhen ngjarje kohësh të trazuara të nënqiellit shqiptar, si vitet e 80-ta, 90-ta e më pas, deri midis tri linjash paralele ngjarjesh: Shqipëri - Kosovë - Mërgatë.

Në romanin "I huaji, ai Kosovari" shkrimtari flet për kohë tjetërsimesh brenda kombëtare, një tëhuajësim deri në armiqësi e moskomunikim total, pas viteve 80-ta, midis dy vendeve Shqipëri - Kosovë, të parit, nën paktin e bashkëveprimit kinez, ndërsa të dytit, nën "bashkim-vëllazërimin" jugosllav. Pra, është një roman me përmbajtje historiografike, bazuar në kujtime dhe argumente.

Përmbajtja e këtij romani sjell përshkrime fragmentare, sipas njohjeve, përjetimeve apo leximeve të shkrimtarit, të cilat përvijojnë në plotëni jetën e shqiptarit, matanë dhe këndeje kufirit, me mjaft vështirësi, katrahura që të ngjallin neveri e të lënë shije groteske.

Shkrimtari tregohet mjeshtër rrëfimi, me përvojën e autorit të disa veprave artistike. Për ironi, rrëfimin në "I huaji, ai Kosovari" e fillon me arritjen e kryeprogonistit në qytetin pa kishë. I habitur me faktin se ku e kishte dërguar fati apo rrjedha e jetës, shprehet: "*Qyteti ynë nuk ka kishë, kjo nuk është ndonjë hata e madhe, pasi pothuajse shumica e qytetarëve janë myslimanë. As xhami nuk ka, sinagogë jo se jo! Hafizja e çmendur është myslimane*". Pra, kishë nuk ka, por "qyteza e rrënuar e ilirëve, po. Mbase, nostalgjia për këtë vend, e ka shtyrë autorin që rrëfimin e parë ta titullojë "vendi i shenjtë".

Liria mbetet vetëm si refleksion artistik. Modelin më të mirë për këtë e jep Hafizja e çmendur. Në fakt, kur Kosova është e ndaluar të përmendet, askush nuk guxon ta bëjë këtë, përpos Hafizes së

çmendur, e cila këndon edhe këngë për të, po asaj nuk ia var kush veshin, edhe kur bërtiste nëpër rrugët e qytetit: "Jetën e japim, Kosovën nuk e japim". Atë nuk e vënë re, sepse ajo edhe tek varrezat falet e lutet herë si kristiane, e herë si muhamedane, gjersa në fund reciton citate të Mao Ce Dunit. Mjerimi i këtij personazhi, e përshkruan konfuzitetin fetar dhe tiraninë për një admirim të rrejshëm, gjatë një bashkëveprimi shqiptaro-kinez që më vonë rezultoi humbje kohe, grotesk në këndvështrimin e sotëm, por që padyshim pas vetes la gjurmë të thella tek një shtet i vogël, siç qe Shqipëria. *Kryepersonazhi* është Kosovari (natyrisht, banorët do ta quajnë "I huaji" dhe rreth ardhjes së tij fillojnë të thurin legjenda, ndonëse në vitin 1989, ai do të vinte si student në Tiranë. E panjohura për të, këdo e vendos në dilema të shumta. Qëndrimi i tij shpejt do të bëhet i shpjegueshëm, kur ai fillimisht e refuzoi vizitën për në muzeun e postës së kufirit, i tëri i mbushur me fotografi vrasjesh në përpjekje të kalimit të kufirit. Aty gjendeshin edhe vargje të shkruara për ushtarët e kufirit, madje dhe qenin e kufirit, që kishin rënë heroikisht duke e « mbrojtur » vendin nga ikësit. Romani "I huaji, ai Kosovari", analizuar përmes unit subjektiv si raport i ndërvënë me objektin e rrëfimit, krahasuar me veprën e A. Kamysë "I huaji", ka të njëjtin tëhuajësim individësh, qëndrimi misterioz i të cilëve të lë shijen e **bukës së absurdit**. Rrëfimi përjetohet si diçka e kohës së shkuar që ruhet në muret e shpirtit, pastaj përkalimi nëpër realitetin jetësor dhe realitetin fiktiv ndihmon në formimin e personazhit narrator. « I huaji-Kosovari » identifikohet me vendin e shenjtë, me identifikimin e varreve, gjuhës dhe gjakut. **Kosova** për ta (banorët e qytetit pa kishë) ishte krejtësisht e huaj, madje më e huaj se Madakaskari, Kosova që ishte veçse një fluturim zogu larg tyre dhe kishin të njëjtë emrat e mbiemrat e tyre. Kosova, në të cilën kishin shkuar me mijëra herë prindërit e tyre, për bukë e për luftë. Gati një dekadë më vonë, ngjarjet e vitit 1999 jepen përmes ditarit. Është e pranishme edhe forma epistolare, përpos memoareve që përbëjnë pjesën më të madhe të përmbajtjes. Në këtë ngritje piramidale rrëfimi, një personazh në pritje të premtimit dhe identitetit të përhumur është Doruntina. Asaj i imponohet dëshira për arratisje, kudo qoftë, veç larg vendit të izoluar, prej ku edhe Zoti për një kohë pati hequr dorë! Situatat rrëfimore janë gërshetim interesant, edhe kur rastisim në zvarritjet kërmillore të individëve të përhumur, edhe kur ndeshim vigjilencën e atyre që nuk hezitojnë të marrin arratinë, në emër të lirisë. Përgjithësisht, një krahasim me romanin "Procesi" të Franc Kafkës, pa dyshim se vihet re, ndonëse jo si identifikim tërësor. Sigurisht, në këtë ide na shtyn fakti që edhe dëshmitë e rëndësishme janë futur nëpër kurthe keqkuptimesh. Në këtë rast, edhe po të mos ishte koïçidenca/përngjasimi i personazheve, është ngarkesa psikologjike dhe involvimi i tyre në dramën kolektive.

### Rrëfim në sfone kujtimesh

Romani "Një natë te Luiza", që nga titulli është gjetje e duhur dhe ngacmuese, drejt një leximi të pakushtëzuar. Indi ndërlidhës midis kohëve, të tashmes dhe të shkuarës, krijon linjën midis fatit të një farmacisti dhe një gruaje "të harruar", ndonëse në përpjekje të vazhdueshme të ruajtjes së identitetit. **Fillimi dhe mbarimi** i romanit, ngrihet si parabolë midis dy linjash, ku konturohet përmbajtja me të gjitha rrjedhat e rrëfimit. Me një stil konciz rrëfimor, si model i Stevan Cvajg-ut, shkrimtari Arbër Ahmetaj na vendos brenda një ngjarje - enigmë, e cila do të kuptohet vetëm pas leximit të vëmendshëm dhe ndërlidhjes së njëpasnjëshme të sekuencave rrëfimore. Përpos narratorit - farmacistit, që në fletët e para të romanit njihemi me Luizën, e cila vinte nga Islanda (kishte studiuar për letërsi, në Rejkjavik dhe Dublin), por kishte ëndërruar të bëhej aktore në Londër. Dikur,

për arsye shëndetësore kishte qëndruar në Gjenevë, ku e mësoi frengjishten, gjë që i mundësoi të komunikonte edhe me vetë kryepersonazhin, që u njohën gjatë një seance nënshkrimesh të promovimit të librit të tij të parë të përkthyer e botuar në frengjisht. Rrëfimi merr trajtë besimi të ndërsjellë, kur ata të dy zbulojnë preferencën e përbashkët - letërsinë. Në këtë temë do të pikasen edhe kodet morale dhe vlerat e shijet e artit. Madje, në një mbrëmje të njohjes së tyre, ata folën gjatë për letërsinë dhe autorët: Samuel Becket, Pol Verlen, sikurse më pas: Homerin, Danten, Shekspirin, Tolstoin, Dostojevskin, Markezin, Coelhon dhe kuptohet Floberin ! E admironin Floberin për zotësinë e gjetjes së Emës - Ema Bovarisë. Të gjithë këta romancierë të mëdhenj, kanë shtjelluar artin e tyre mbi drama individuale dhe kolektive, me një bazë të fortë dashurie, herë - herë edhe për të përmbysur klishe e kode tradicionale. Kësisoj fillon edhe rrëfimi i shkrimtarit Ahmetaj, fiksion i të cilit qe bërë Lina J. Në këtë raport, ndoshta mjafton edhe kjo shkëputje: *"E kam lexuar me një frymë romanin tënd" Por, ma zuri frymën"* (Luiza). Pas këtij komenti pason revanshim i farmacistit: (Mirënjohës për leximin dy javor, në të kundërtën (Luiza)do të kishte bërë shopping, do të kishte qëruar patate ose bërë ndonjë gjë tjetër, larg leximit). Pastaj takimi me Ana Mennem-in sjell të tjera horizonte kuptimesh. Sigurisht, jo vetëm për nga koinçidenca e emrit me Marian, personazhi i Ahmetajt: Lina J. - Nora - Ana Mennem, do të mbeten gjatë në kujtesën e çdo lexuesi!

### Letërsia e përkthyer dhe sistemi i pritjes

Letërsia shqipe e shkruar jashtë kufijve të shtetit *Amë* e ka të patjetërsueshme të ruajë urat lidhëse, midis dy gjuhëve, kulturave, traditave. Romani "Një natë te Luiza" është tipik për të dëshmuar përpjekjen e shkrimtarit Ahmetaj për të sajuar një roman postmodern, duke përdorur elokuencën rrëfimore, në një anë me realitetin e hidhur e të ashpër që e kaluara lë në vendin e tij, që si realitet është i pashkëputshëm nga ai Shqipëri - Kosovë, po sigurisht me problematika, jo tërësisht të ngjashme, realitetin shoqëror dhe dramën sociale që për dy a më shumë dekada ndeshet me fatin e shqiptarit, në Shqipëri, në Ballkan e gjetiu trojeve tona. Teksa në pjesën tjetër të Evropës, veçmas në Zvicër, ku edhe zhvillohet kryekëput ngjarja, autori i jep tjetër përmasë të kuptuarit të artit, vlerave njerëzore, kulturore e intelektuale.

Romani karakterizohet me përdorimin e lirshëm të *unit autorial*, si dhe transparencës së ngjarjeve, ndonëse ato shkruhen apo botohen shumë më vonë, ngase kanë ndodhur. Horizonti i pritjes arrihet këndshëm, pasi është roman me fraza jo të gjata apo të lodhshme, falë njohjes së stilit të shkrimtarëve të "Brezit të humbur", (E. Heminguej, E. M. Remark) megjithëse, Ahmetaj arrin që ta ruajë stilin ajzbergian, përderisa mjeshtërisht lexuesin e fut në labirinte kërkimesh vetanake, prej ku ata edhe vetë mund ta imagjinojnë vazhdimësinë e ngjarjes, gjithmonë sipas horizontit të pritjes ose ngritjes kulturore që posedojnë, në raport me vlerat e letërsisë. Të dy romanet: "I huaji, ai Kosovari" dhe "Një natë te Luiza" me formësim shtresash rrëfimi tejet filozofike, cilësohen si vepra me vlerë, për nga ndërtimi kompozicional dhe mesazhi universal.

## **Një natë tek Luiza (Nga Arbër Ahmetaj)**

*Një roman i shkruar bukur*

*Petrit Palushi*

Është një roman për humbjet, dis-ekuilibret njerëzorë, ftohtësinë e marrëdhënieve, jashtë happy-endeve të pritshme, një shpalime kohësh dhe zhvendosja e ngjarjeve të ndryshme si një hapje e matrioshkave ruse, roman me të papritura, ku pikërisht të papriturat japin kupshtimshmerinë se ke para një prozë në cilësinë e modernes dhe do lexuar vetëm si e tillë. Ka fabul dhe një prozë mbahet dhe jetësohet nga fabula, ndryshe nga shumë proza romanore ku linjat mbeten të shpërndara dhe pa kurrfarë pika takimi. Arbri në këtë roman ka një filozofi të veten letrare që ka të bëjë me mënyrën e rrëfimit dhe operimeve në prozë me ato elementë që i japin funksionalitet prozës dhe e bëjnë tejet të lexueshme. Autori e ka titulli romanin "Një natë tek Luiza", por unë mbrëmë duke e lexu romanin krejt-e-krejt, m'u kriju përshtypja se po kaloja një natë të lume bisedë me autorin duke shkërmoqë romanin fije-fije.

## **Një prozë që buron nga e vërteta jetësore dhe artistike**

*Mbi romanin "Një natë te Luiza" të shkrimtarit Arbër*

*Nga Kujtim Morina*

Para disa muajsh, po kërkoja në librari një libër për të lexuar nga Arbër Ahmetaj. "Fletëhyrje për në varr" apo "Varri i braktisur" më dukeshin tepër të zyrtë dhe zgjedha "Një natë tek Luiza". Kisha dëgjuar që në fillim të viteve 90, për një student të viteve të larta të mjekësisë që shkruante prozë nga ata që e marrin seriozisht e kam fjalën, dhe pastaj për disa vite nuk u ndje shumë derisa emigroi në Zvicër ku jeton prej dy dekadash.

Romani "Një natë tek Luiza" nuk ka strukturën tipike të romanit, më tepër janë tregime që duken pothuaj të shkëputura nga njëri-tjetri, vetëm personazhi kryesor që shpesh identifikohet me autorin, lëviz në të gjithë romanin që nga fëmijëria deri në moshë të mesme. Gjetja e Arbër Ahmetaj si prozator për mendimin tim nuk është aq shumë tek trillimi letrar megjithëse e ka edhe atë por tek personazhet me bazë të vërtetën jetësore, depërtimin në botën e tyre të brendshme shpirtërore, mungesën e komplekseve për t'i pasqyruar ata në shumë plane duke hetuar thellë në unin dhe egon e tyre dhe një satirë e hollë që i shpon ata tej për tej. Jeta bulëzon në këtë roman që nga mesi i viteve 80 të shekullit të kaluar me normat dhe paroditë e regjimit komunist me vitet e vështira të tranzicionit në Shqipëri dhe jetesën në emigracion.

Proza e Arbër Ahmetaj ka një figuracion që e bën atë tërheqëse dhe ndërthron një forcë vargu migjenian që e zhyt lexuesin në rrëfimet e tij interesante. Nganjëherë duket e vështirë, kalimi nga një episod apo kapitull në tjetrin por kur e fillon atëherë të tërheq shtjellimi i fabulës dhe vëzhgimi i mprehtë i autorit. Zvicerani Michel Pichon shkruan për prozën e Ahmetaj si një "shkrim që luhetet mes letërsisë, esesë dhe filozofisë". Edhe në qoftë kështu, është jeta që lëvrin dhe ndjehet në të gjitha poret e saj në prozën e këtij shkrimtari. Ndryshe fantazia letrare e pambështetur në realitet mund të arrijë në bestseller por që e ka jetën e shkurtër.

Nuk ka në këtë roman skena të nxehta erotike që edhe mund të priten nga titulli por përshkrime romantike të thella që nuk bien në sentimentalizëm dhe jetë me të gjithë vrullin e saj. Madje janë

momentet e veçanta me gjetjet apo dialogjet që të mbeten në mendje dhe kupton se aty është arti në rrapëllimat e kohës që e shijon momentin deri në përjetësi. Proza mund të kishte më shumë dialog por ky është stili i shkrimtarit me një paralelizëm apo personifikim të jetës me natyrën dhe një depërtim të thellë në vetëdijen e brendshme të personazheve që krijon.

Autori iu vë tituj të vecantë tregimeve apo kapitujve të librit që mund të lexohen edhe ndarazi. Do të veçoja "Shenjti Valentin", "Kaprollja e plagosur", "Gratë heroike hidrocentralase", "Alpenperle" ku duket se autori ia ka arritur një përshkrimi dhe sinteze artistike të gjendjeve dhe situatave që e ndjellin lexuesin t'ju shkojë deri në fund. Këtë të fundit e kisha lexuar si tregim të veçantë në internet dhe më shtyri të lexoj edhe diçka prej prozës së gjatë të këtij shkrimtari.

Pas leximit të këtij romani, nuk kam më ndrojtje të lexoj edhe romane apo tregime të tjera të tij që më frenonin pak nga titujt apo edhe mosnjohja e tij si shkrimtar. Besoj se ne në përgjithësi vuajmë nga paragjykimet apo stereotipet e krijuara për autorët shqiptarë dhe bëjmë vlerësime pa i lexuar dhe pa menduar shumë se shkrimtari si çdo profesionist tjetër evoluon në zejen e tij. Pastaj kjo është rrjedha e letërsisë shqiptare sidomos pas 90-s dhe duket që autorët që kanë emigruar janë më të lirë të shfaqin talentin dhe priret e tyre qoftë edhe nga statusi i tyre më i pavarur në shoqëritë ku jetojnë.

### **Një letërsi e butë...**

www.shqiptari.eu 18 mars 2016

*(Fjala është për romanin "Një natë tek Luiza" të shkrimtarit tArbër Ahmetaj).*

### **Kënaqësi leximi**

*Bajram Sefaj*

Pasi që, më kënaqësinë më të madhe, kisha lexuar romanin e tij të parë, "I huaji ai Kosovari", mezi pritja të takoja autorin e tij, do të thotë, Arbër Ahmetajn, që njihja prej kohësh. Por, tash që, ndërkohë kisha lexuar romanin e tij, në sytë e ndjenjës sime, ishte rritë edhe më shumë, kishte marrë pamje hyjnore, mund të them, pa u trembur fare se e teproj!

Romani i tij i parë (për mua!), sipas emrit (titullit) që mbante, me trembi në çikë, (uh, çfarë do të thotë kjo: edhe "I huaji (edhe) ai Kosovari").

Aman, aman!

Në fakt, vetë i titulli provokues i këtij romani (për mua dhe të gjithë lexuesit e tjerë shqiptarë kosovarë!), ishte karrem (me rrema!) që, me etje t'i gjuhës leximit. Gjithnjë me pyetjen krahaqafë pse ai titull dhe çfarë domethënia ka: "I huaji ai Kosovari"! Mo' Zot, e ka atë domethënie denigruese, përbuzëse e nënçmuese që, mjerisht, përditë e më shpesh, sidomos rrugëve të Tiranës, ua kap veshi kosovarëve të gjorë. E ata, të patrazuar fare, vazhdojnë ta duan, deri në dhimbje përvëluese, Shqipërinë, kur është Nëna e tyre e vetme e, tjetër nuk kanë!

Jo, ore, ç'po thua. Je në veti, ti! Nuk ishte hiç ashtu. Ishte krejtësisht ndryshe. Jo vetëm ..."ai Kosovari", por të gjithë lexuesit e tjerë, do të binden, bashkë më të, se romani në fjalë, paraqiste

diçka tjetër, të kundërt! Këtij romani dhe autorit të tij, z. Arbër, i bëra jehonë të madhe verbale, ngado që u solla e shkova, vërdallë. Diçka nga këto fjalë të mira të mia për romanin e tij, kishin gjetur rrugët, qoftë edhe misterioze, e ishin "dyndur" në vesh të Arbrit.

Dhe, kur me në fund, erdhi dita e (ri)takimit me të, ishte pasdite e vrugët e ditës së diell, më shi të imët, në Gjenevë.

Shi binte në.... Gjenevë!

\*

Tash pas aq shumë vjetësh që jemi parë më Arbrin, kisha përshtypjen se e shihja edhe e njihja për herë të parë. Atë burrë të ri, plotë trupin Tropojë e virtyte tjera të asaj krahine legjendare të vendit tonë. Ishte po ai Arbëri i mëparshëm, i ri, shtatlartë e plot gjallëri, por tash e shikoja dhe e ndjeja disi ndryshe. Me një respekt më të madh, sado që ishte i ndrydhur. Si për të dëshmuar se e di fare mirë se librin ia kam lexuar me kujdes të përqendruar dhe se e kam "reklamuar" gjithandej, sa që, një bashkatdhetar veçse nuk ma kishte grabit e marrë nga dora, posa u takuam, në dorë m' i lëshoi edhe disa ekzemplarë të romanit "I huaj ai Kosovari" bashkë me porosinë që t'ua ndaj miqve të mi! Çdo gjë ishte e qartë. E, për mua, ka ndonjë gjë të re, derisa me bishte syri ia vidhja titullin e romanit të radhës "Një natë tek Luiza"! Pa pikë hezitimi, si një krah dallëndysheje tropojane, hapi kapakët e romanit dhe në faqen e parë të bardhë të tij, shënoi: Bajramit, një letërsi e butë, për një mik të mirë!

\*

Romanin "Një natë tek Luiza" e marr prej duarve autorit, menjëherë lexoj me lezet (siç thonë helmet e Tiranës!), akoma më të madh se të parin, dhe, aty për aty, filloj të zihem, të tjerr e të meditoj mbi te, si ta shkruaj një shkrim të shkurt, jo pse di shumë i zbërthej e komentoj veprat letrare (kush ai që din ta bëj këtë punë, aq mirë e me kompetencë, dilemë e temë tjetër, është kjo!), por, vetëm aq sa të ndaj kënaqeshin e gostinë më të tjerët, dhe, në këtë mënyrë, t'ju bëj thirrje, (që mos të jem egoist!), që, edhe të tjerët të ulën rreth tryezës se quajtur "Një natë tek Luiza".

\*

Kur me në fund, u gjenda sy m' sy, me faqen e parë të bardhë (të tmerrshme) të kompjuterit, kur mendova se i erdhi vakti ta them fjalën time për këtë vepër, në faqen e parë gjeta titullin e shkrimit: letërsi e butë, për...! Dhe, akoma ende, pa i lexuar as 20-30 faqet e para romanit pash se kësaj e butë, duhej shtuar edhetribute të tjera: letërsi e butë, po, d'accord, por edhe letërsi e mrekullueshme, letërsi e lezetshme, letërsi e ëmbël... Tash nuk kam takat të përgjigjëm për të gjitha këto "akuza" që ia bëj romanit "Një natë ke Luiza", sepse, në rend të parë, nuk jam i zoti t' i dalë përballë një orteku të tillë rrënues, e, së dyti, nuk dua, kur, thjesht e vetëm me një fjalë (a fjali!) mund të përbyll gjithçka: merrni e lexojeni këtë (krye)vepër të letërsisë më të re shqipe! Kush nuk pajtohet, ka punë me mua! Ja, ku jam!

\*

Malli i mirë, zotnia serbes, thotë një urti jona e moçme popullore! Arbër Ahmetaj shkuar mirë, paq shkruan, shkurt shkruan, qartë shkruan, prapë, bukur, paq, shkurt, qartë,... prapë... I thërras në ndihmë, argatë të me hyjnë nën krahë e këtë punë të vështirë arsyetimi, pafajësi



argumentimi e vlerësimi, vetëm mendimet e tre kritikëve të huaj, dy nga Zvicra e një nga Bukureshti i Rumanisë. Ata thonë: "Ahmetaj është shkrimtar i aftë që përvojat personale t'i ngrejë në lartësinë e një mesazhi universal", ( Bastien Fournier ), "Shkrim të luhatet mes letërsisë, esesë dhe filozofisë (Michel Pichon, që të dytë nga Zvicra), ndërkaq, Gabriella Lupu, nga Bukureshti, ndër të tjera thotë se: "Prozat e tij, (të Ahmetajt, pra) të japin kënaqësi leximi po aq sa të bëjnë të reflektosh".

\*

Megjithatë, kur është fjala për romanin në shqyrtim, të them se midis kopertinave të tij, fshihen (ruhen) ty margaritarë fort të çmuar: "Shenjti Valentin" dhe "Gratë heroike hidrocentralase". Pa e eklipsuar, aq me pak pa e mohuar vlerën e asnjë tregimi tjetër, as krejt s'rrëfejnë ato 182 faqe tekste modern e të shkëlqyer, për mua tregimi më i mirë, megjithatë, ishte ai për "Gratë heroike...", ndoshta pse në gjene kemi diçka të përbashkët: ai është kundër enverist e unë kundër titist! Edhen një e përbashkët: gjersa unë jam jurist, ai është farmacist, profesion, të cilin me dashuri e ushtron, sot e kësaj dite, në qytetin piktoresk Sion të Zvicrës, ku, prej vitesh, jeton, punon dhe krijon.

## **Bajram Sefaj**

***Gazeta "Bota sot" on line, Prishtinë, 9 maj 2017***

Po lexoja romanin e vogël, nuk e kam fjalën thjeshtë për numrin e faqeve 182 gjithsej, por ne kuptimin përkëdhelës, të diçkaje që na pelqen ta mbajmë afër, që ka vlere të madhe, "**Një natë te Luiza**", të Arber Ahmetajt e që përbën një zbulim për mua, të vonuarin! Diku në faqen e nëntëdhjetë e tre-katër të tij, tek po ia "lidhja lëmesat" tregimit të shkëlqyer, të saktë në vërtetësinë e tij si të jetuar, "Shenjti Valentin" e mbylla librin. E lash mënjanë. Isha në kokërr të shpinës në shtrat. Synoja të mbytesha në pusin e zbërthimit të përmbajtjes së atij tekste antologjik, kur vrik, në katin e tretë të ndërtesës se banimit përball meje, u hap një krah i flegërës së dritares-derë. Ajo nuk doli e tëra, veç një dorë e gjysmë e kraharorit të saj, si rufe në të kthjellët u shfaq në atë dritare-derë ballkoni. Përnjëherë, në sektorin e zemrës të kraharorit tim, shpërtheu një zjarr flokëverdhë etjeje për ta parë edhe njëherë. Nuk mund ta besoja se që aq e bukur, aq madhështore sa e qiti flegra e derës. Në të njëmijtën pjesë të minutës, ajo u zhduk pas qelqeve, ndërkaq, në mua përnjëherë u shemb diçka, u thyen xhamat e gjithë botës, u krijua një pellg i trashë lëmashk rreth zemrës. Çfarë po ndodhte? I ngjante ajo krijesë Luizës së Arbër Ahmetajt apo që një vegim zhuritës i sapo zgjuar nga palat e kujtesë? Në atë çast zbrazëtie të krijuar rrufeshëm, vetëm për një pjesëz sekonde, e luta Perëndinë, shkëlqesinë e saj të gjithëfuqishme e çudibërëse, që dera dritare e atij ballkoni, të hapej përsëri dhe, serishmi të dukej ajo me atë fustan të bardhë të mbushur plotë kraharorin gjinj e cica të shëndetshme...! Për të qenë i sigurtë deri në fund, luta Zotin e plotëmëshirshëm që nga jo derë, të mos dilte më kurrën e kurrës askush tjetër pos saj, bukuroshes së bardhë, të cilën çasti e krijoj

në mendjen time, apo vertet e kisha parë? Pas disa sekondash, mendimet e mia u rikthyen tek romani që dergjej në shtrat pranë meje. Po bëhesha xheloz për kolegun tim me të ri pa e ditur saktësisht nëse kjo xhelozia lidhej me cilësinë e mrekullueshme të tekstit të tij letrar, apo me faktin se ai kishte kaluar një natë me një nimfë nga veriu i Europës?

Papritmas, po i njëjti xham, në ndërtesën përballë, bëri një rrotullim të beftë duke riprodhuar, si në pasqyrë, krejt pamjen e ndërtesës së apartamentit tim të banimit. Në atë kthesë të ngushtë, në atë shkrepje rrufeje, gjeta kohë për të lutur prap perëndinë e gjithëpushtetshme, që të mos shfaqej kush tjetër përveç asaj! Por, jo! Ashtu siç ndjeja një lloj frike të brendëshme, të thellë e të turbullut, në ballkon u shfaq një tip zgatavël e i shëmtuar, me një veshje të keqe, me një si hërrke barinjsh të bjeshkëve tona të thata, me një xhup të errët, me shumë lesh në jakë të saj, me kapelë të madhe, me një filxhan kafeje në dorë. Lëshoi me nxitim filxhanin mbi një tavolinë, a ç'dreqin ishte ajo e, nga një xhep i xhybes nxori një telefon portabël, sa për një xhevap të shkurtër blic me ndokënd. Pastaj, me ngutë hallakati xhepat e xhupit, sikur nga andej synonte të nxirrte revolverin zeher e të ma shkrepnte në lule të ballit. Vura re se nga ata shumë xhepa si të shqepur e të panjohur krejt, nxori një pako cigaresh me një çakmak të madh. Me një rrotullim të shkathtë gishtash e ndezi duke nxjerrë një flakë të verdhë, të aftë jo veç me ndez cigaren e tij të pshurtë, por me më kallë flake mua e krejt lagjen. Fill pasi tërhoqi dy-tre tymra të thellë, iu gjuajt filxhanit të kafes. Bënte ftohtë i madh. Ishte pas dreka, ora shtatëmbëdhjetë e ditës se dytë të muajt shkurt, sivjet. Avujt e filxhanit të kafes, shtëllungat e tymit të cigares, dogjën e asgjësuan krejt ëndrrat e mia, shpresat se Ajo do të shfaqej në atë ballkon të mallkuar. U drodha në krah, gjumë askund, s'ishte kohë gjumi, filloi të reshte dëborë. Edhe jashtë edhe brenda. Iu riktheva romanit, "Një natë tek Luiza", personazheve të tij, misterit të emocioneve dhe hijeshisë së përshkrimit të tyre. Letërsia e mire ka aftësi ta na marrë me vete, të na transformojë. Të na bëjë të perjetojmë çaste magjike. Arbër Ahmetaj, jo veç me këtë roman, na dëshmon se shkruan letërsie të një cilësie shumë të lartë. Nuk doja ta mbaroja romanin, doja të udhëtoja me të në thellësitë e kujtimeve të mia, në ditët plot sharm e gëzim të rinisë. Por, prap nuk jam në gjendje të shpjegoj: përse ktheja herë pas here kokën nga ajo dritare? Shpresoja ndoshta, se pas realitetit brutal të zgataveleit me hërrke barinjsh, burrit me duhan e me kafe, egzistonte edhe një tjetër, një mbirealitet, ai që më pëlqente, që më bënte të ëndërroja, të ndjehesha mire, ai i gruas së bardhë..., i Luizës simel!

## SAGA ROMANORE E ARBËR AHMETAJT

### 1. Një autor tipik i brezit novator post '90

Shkrimtari Arbër Ahmetaj, një autor tipik i letërsisë novatore të brezit '90, e ka kryer me përkushtim, talent e ndershmëri detyrën e vet si shkrimtar: ai ka shkruar (në dijeninë time) pesë romane nga viti 1993 deri më 2019, stilistikisht të ngjeshur në unitetin e kronotopit - të botës së projektuar në kohë-hapësirën e poetikës së tij.

Narrativa letrare e Ahmetajt shtjellohet rreth legjendës së një "uni", që si një bimë kokëngjeshur, plot ëndrra të pamorta, çan tokën e rraposur apo të betonuar me ideologjitë totalitare; nga instancat e dhunshme shoqërore/familjare për t'u konfirmuar në një farë hapësire thuajse-lirie. Ka një hierarki mizore, vertikale në romanet e tij. Por i vogli bën luftën e vet, lëshon apelin e tij, qoftë dhe të dobët në botën e ashpër e të shplarë.

Ligjërata letrare e Arbërit ka përpunuar me kohë një parim të ironisë infantile, një poetizim vetëironik, i cili e ruan një "pathos të distancës" nga protagonistin i rrëfimit, që është gjithnjë në vetë të parë. Ironia e distancimit nganjëherë gjen mjete të efektshme si në romanin "Varri i braktisur" (Skanderbeg books, 2009) ku rrëfimi nuk i referohet "unit" tradicional, por "vetes sime" ("bashkë me veten time u ndodhëm në një ditë vjeshte..." "Kur e rrihin veten time, unë, i shikoja rrahësit në dritë të syrit për të vërejtur se pse e bënë me aq zell atë punë...").

Që nga romani "Flet hyrje për në varr" (1993) e deri tek i fundit "Procesi 3/K 19...", kemi trajektoren e një sage nga fëmijëria tek burri i pjekur. Duke përjashtuar (ndoshta jo) vëllimin me tregime "69 gra" ("Skanderbeg books), të pesë romanet e Arbër Ahmetajt përbëjnë një pentalogji ku narratori dëshmon në vetë të parë dhe është kamera ku fokusohen të gjitha fijet e botës.

Bota është e koklavitur, kuptohet, dhe heroi i Ahmetajt rritet duke deshifruar me përjetim e peng shpirtëror thurrimën e botëpleksjes shqiptare nga mitologjia e diktaturat, deri tek tabutë dhe drama e maskës së heroit - çmitizimi dhe çmeritja. Gjithsesi letërsia e Ahmetajt është e ngjeshur. Asketizëm. Regjistrat stilistikë janë të ndryshëm, të larmishëm. Ato ndryshojnë papritmas, përveç një gjëje që shkrimtari i ruhet: fjalomanisë. Përftohet një prozë e presuar, shumë afër kondensimit me mjetet shprehëse të poezisë. Si duket këtë kondensim të shprehjes Arbëri e ruan si trashëgimi të vyer të fillesave të tij letrare si poet, zhanër të cilin e lëvron rregullisht. Por sot po flasim për virtytet artistike të prozës së Arbër Ahmetajt. Duket se deviza e tij në prozë është shpallur: asgjë e tpërt, asnjë fjalë të tepërt që nuk i shërben idesë, tablosë narrative, përshkrimit. Asketizëm.

Në këtë poetikë të shkrimit dhe sidomos vektori i përjetimeve dhe kërkimeve të mprehta metafizike e bën Arbër Ahmetajn një ndër autorët më origjinalë të frymës novatore në letërsinë shqipe të brezit post '90.

Një karakteristikë, që personalisht më ka bërë përshtypje te Arbëri është aftësia e tij për të kompozuar lëndën e romanit. Arbri bën disa "prerje gjeologjike" me "sondën" e tij në rrafshet sociale të ndryshme (por dhe nga kohë të ndryshme të staveve moshore: fëmijëria, adoleshenca, rinia, pjekuria), prej nga merr e shtjellon linjat e personazheve që solojnë në kate të ndryshme në një stil contrapunkt-i. Personazhet shtegtojnë nga njëri roman në tjetrin, e po ashtu dhe realet apo bëmat (tipike për sagat romanore).

Të tria kohët e rrëfimit lidhin skajet e unitetit të personazhit të shkrirë njësh me ëndrrat dhe utopitë. Ndoshta Shqipëria Veriore me brengat e saj, me mitet dhe ashpërsinë e përcudnimit, me shfytërimin e degradimin, por dhe me heroikën e rezistencës shpirtërore në kufijtë e shterrimit e gjen veten për mrekull te ky cikël romanesh të Arbër Ahmetajt. Te romani i mrekullueshëm "I huaji, ai Kosovari", kësaj bote me dhimbje aq shituese, i shtohet

gjysma e përmasës së dhimbjes sonë të fshehur përbrenda: Kosova. Po me çfarë elegance në shmang të patetikës dhe banalitetit! Thurja kompozicionale e zhdërvjelltë nuk e len interesin e lexuesit të ftohet. Dhe sigurisht, ndërkëmbimi i regjistrave letrarë që derdhen nga një formë në tjetrën, njësitë e thërmuara të tekstit, dhe sidomos, legjenda e misterit të një dashurie, së cilës mospërmbushja i ka caktuar fatin të mbetet e përjetshme... dhe tragjike. Personazhet e Arbër Ahmetajt dallohen, shquhen me sy, edhe kur skicohen shpejt.

## 2 - Një roman mbi romanin e romanit

Romani "Një natë te Luiza" (Skanderbeg books, 2015), i katërti i sagës narrative të Arbër Ahmetajt, mendoj se është më i gjalli, më eleganti dhe i më i mençuri. Jo pse përmbillet në një të tretën e romanit me një idilë aq fine, delikate e të paobsesion me Anna Mennem, sa nuk të shqitet nga mendja, porse dy protagonistët e kësaj idile janë, në njëfarë mënyre, enë dhe pasqyra të gjalla njerëzore, që bartin barrën dramatike të përvojës. Andaj dhe idila e tyre kërkon "guackën" (moluskun) e vet për të endur me ngutin e kohëzgjatjes një vend qetë e të heshtur (silentium) për të endur në vetmi e zhbirillim të ndërsjelltë rrathët e sedeftë të perlës, sikundër se është në fakt ky vend ideal - Hoteli Alpenperle.

Jo, jo, për kurrëfarë idili nuk është fjala! Ajo është elegji, sepse kurrë nuk do të përsëritet më ai kulm sublim me dy shpirtrat që u derdhën - pasqyrë në njëri-tjetrin. Adhurim dhe përmbajtje! Më shumë meditime rreth dukurisë së mahnisë. Diç si muzgu tutçevian në poezinë "Dashuria e mbrame" (të shfityruar nga Noli në "Dasma e fundme") me vargun:

*"Ah, si në muzg të jetës sonë/ të brishtë e besëtytë ne dashurojmë..."*

Mahnia e njohjes me femrën, ai grimëçast përshkënditës, fillon me tingullin magjik për shqiptimin e emrit: - Anna Mennem! Diç anagramike: muzikë që të kall harmoni dhe sensualitet estetik, sikundër është koshient dhe vetë narratori duke e përqsaur me muzikalitetin e Lolitës nabokoviane.

Anna Mennem është një krijesë diellore, që kërkon pretekst për të qeshur, por jo për qeshje sipërfaqësore. Ajo ka ngadhënjyer mbi vdekjen (tumorin) përmes këtij të qeshuri, si mjeti më i natyrshëm e më vital për t'iu hapur e dorëzuar Botës, anës së ndritur të saj. Personazhi ynë romancier (ai njihet me të në një konferencë mbi metodat e reja të trajnimit të kancerit), gjithashtu ka kaluar një përvojë, ndoshta shumë më të regjur me vdekjen, pa qenë e domosdoshme që kjo përvojë të ketë të bëjë drejtpërdrejtë me tumorin fiziologjikisht. Tumoret e personazhit tonë rrëfyes i kemi njohur përgjatë leximit të 2/3 të romanit përmes disa tregimeve që lexohen në një natë të qetë e të gjatë tek Luiza, një tjetër e mbijetuar nga "tropikët e kancerit", një vajzë islandeze. Ajo ka kaluar përvoja ekstreme, i ka mbijetuar vrasjes tragjike të të dashurit të saj në një burg të Pakistanit.

Përftohet kësisoj, që personazhet më të rëndësishëm të këtij romani kanë përvoja të regjura me Vdekjen - kush me vdekjen fizike, kush me vdekjen alegorike, konvencionale, shpirtlore etj, etj. Vetëmse linja e rrëfimit që nis e mbaron nga pasditja deri në të thyer të natës tek shtëpia e islandezes Luiza (lexuese dhe komentuese e romanit dhe tregimeve të narratorit), anipse ajo e fiton jetën me "masazh indian" (miku ynë shkrimtar Balil Gjini thotë, se "letërsia nuk ka nevojë për mesazhe, por për masazhe") - ajo është një specialiste letërsie. Pra kjo linjë leximesh nga tregimi në tregim, përbën shpalosjen e profilit jo aq të heroit narator, se sa të një totalizatori të përvojave kolektive - mes të cilit kolektiv ai ka frymuar, shpresuar, vuajtur, ëndërruar, zhgënjyer e dëshpëruar. Ky është heroi ynë qëndror, subjekt dhe formatizues i autorrrëfimit. Nuk është aspak e lehtë përkapja e planeve të dyta semantike, ndonëse akti i leximit është tërheqës, sugjestionues, magjik. Pse?

Bigëzimet kuptimore të presin e shoqërrojnë në çdo paragraf. Ok, vazhdon leximi i islandezes Luiza dhe në fund të çdo tregimi ajo bën komentet e veta, kritikën, sugjerimet, herë me vend, herë pa vend. Diskursi përfshin paksa pasivisht, paksa liberal edhe vetë shkrimtarin. Ndërkohë lexuesi duhet

ta mbushë me mend këtë që kohë që kalon për mikun e ftuar (autorin vetë) i cili rri, pret fundin e tregimit për të dëgjuar përshtypjet e lexueses.

Me çfarë mbushet, ndërsa dy herë citohet vargu i Verlenit për një nevojë dashurie pavarësisht në cilin vend, pavarësisht me kë? Me çfarë mbushet ndërkoha e pritjes për autorin, i cili e ka të pamundur të thellohet në vargjet e poezive të Verlenit? Me meditim, sigurisht! Ashtu si dhe nga lexuesi. Në këtë s'e dimë, sepse jemi duke ndjekur tregimet e mysafirit shkrimtar, që i lexon Luiza, me lëndën e dëshirave të mëdha dhe mungesave dramatike: me përvëlimën e dashurisë së parë, me tabutë dhe tabutet shqiptare lokale e metropolitane, me absurdet dhe nonsenset e dubluara ideologjike et., por ne nuk mund ta qesim absolutisht në harresë kohën e sikletshme që kalon aty narratori (një goxha kohë). Prandaj, paralelisht me leximin e tregimeve të tij, ne nuk duhet ta harojmë mbushjen e kësaj kohe me diç të përligjshme.

Këtë na e kujton venitja e dritës natyrale jashtë; gjumi i papagallit dhe zgjimi i tij, sikundër dhe ndërprerjet me tingujt e fjalëve që thotë; ndezja e dritës, vallëzimet e fluturave dhe insekteve të mbrëmjes dhe, sigurisht, replikat që shkëmben midis pauzave të leximit. Dhe kështu mbushet viskoziteti i ndërkohës së pritjes me këto efekte të jashtme: hurbat e verës, qeshjet sarkastike të papagallit, zilja e derës dhe ardhja e picave, tringëllima e pjatave dhe instrumenteve të ngrënies, e sërish pasthirmat reaguese të gruas që lexon. Intermexot midis leximit të tregimeve janë indekse kohore, kohëmatës, që indeksojnë përafërsisht kalimin e kohës, ndërrimin e shisheve, ftohjen e picave thuajse të paprekura, servirjen e pjatës së djathrave, mishrave, ndërsa shkrimtari (që po lexohet) sodit, vëzhgon:

"Ndërkohë që ajo lexonte, unë kqyrja përreth. Një tufë zogjsh u trembëm nga vizita e papritur e një sorre. Bënë zhurmë, pastaj fjetën. Papagalli u zgjua nga gjumi, t tha dy-tri fraza, piu ujë dhe ia futi gjumit me kokë ndër pupla". Kjo është atmosfera që shoqëron një trajektore jete e përvoje të autorit, momentet kapriçoze të fatit, trillit, imagjinatës e ëndërrimit, krejt ato me çka "është mbajtur gjallë" ai, si njeri, ndërsa Bota e lexon në një Verandë të paqte me muzikë jazz, verë e dërdëllitje papagalli. Kjo atmosferë thyhet periodikisht pas çdo leximi të tregimit të radhës me diskurse letrare, filozofike dhe sidomos etike. Pra në këtë roman kemi romanin e romanit, diskutimin mbi romanin, apologjinë dhe (mos)pranimin e kritikës apo sugjerimeve të lexuesit, moralitetin dhe faksifikimin e imazhit të autorit, klounadën dhe kompromisin e autorëve me pushtetin dhe anasjelltas, mitin e shkrimtarit dhe kush punon maskuar për ta ngritur atë mit dhe forcën e opinionit letrar masiv për të imponuar apo induktuar vlera masive/masovike, si në rastin e shkrimtarit Paolo Coelho.

Anna Mennem thotë gjatë drekës me doktorët e pacientët e konferencës, se vetë ajo është personazhi i vërtetë i një romani të Coelho ("11 minuta"), por të gjithë aty e lëvdojnë Coelho, edhe pse romanin, ajme, askush nuk e ka lexuar. Të nesërmen në kioskën përballë hotelit janë shitur të gjitha kopjet e këtij romani. Por narratori ynë i ka lexuar vetëm një roman këtij shkrimtari ("Alkimisti"), pastaj është zhgënjyer nga narrativa masovike e dy tre librave të tjerë të tij dhe ka vendosur të mos e lexojë më, edhe pse tundimi është i madh, tani që merr vesh që Anna Mennem paska qenë prototipi real i shkrimtarit brazilian.

Megjithatë autori nuk bën kompromis në shijet e tij dhe nuk e lexon romanin e tij. Nëqoftëse lexuesi nuk lexon në këtë histori një metaforë të ndarjes së letërsisë së vërtetë nga epidemia masovike e narrativës banale, kinse letrare, shundi i përditshëm që vlerësohet me çmime, - atëherë ai e ka të vështirë të shijojë letërsinë e thellë serioze dhe artistike.

\*\*\*

Me këtë roman të parafundit, për romanin e fundit të Arbër Ahmetajt kam shkruar vjeshtës së vitit të kaluar, (teksti i përmendur nga autori publikohet si vijim i këtij shkrimi - *shënim i botuesit, RL*) na përftohet një sagë kaleidoskopike ku marrin pjesë të tria kohërat të lidhura në një nyje-komb në grykë. Lufta këmbëngulëse me rrëfimin dhe formësimin e "statujës së brendshme" ia ka shpërblyer bujarisht mundin Arbërit në 5 romane organike të shkëlqyeshëm.

### 3- Dhe « Procesi 3K/1988 »

Arbër Ahmetaj sapo ka botuar një roman, do të thoja përpirës, me një gjuhë të kthjellët e të gjallë plot metafora e ironi surreale. Rrëfimi është kompozuar duke mobilizuar përjetimin e ankthshëm e rebelues të një studenti në vigjilje të diktaturës në prag të falimentit të saj dhe në fillim të përrallës demokratike kur nis riciklimi në pushtet i po atyre njerëzve që kanë qenë foljet ndihmëse të rregjimit totalitar. Narrativa përbën një sagë të "iluzioneve të hidhura" të një breznie të tërë, me fëmijërinë, adoleshencën, rininë dhe pjekurinë e personalitetit që del nga një diktaturë gjakatare dhe hyn në një komedi të Zezë të hipokrizisë mizore. Është lloji i romanit "portret artisti në rini", ku spikat, përveç heroit të rrëfimit kinse autobiografik, personaliteti i fokusuar misterioz i personazhit të traumatizuar Kosta P, një personazh-baladë, i marrë peng nga Sigurimi. Një personalitet ekcentrik, i shtrirë në të dyja kohët.

Arbër Ahmetaj ka demonstruar hijshëm administrimin mjeshtëror të historisë së heroit me historinë vetjake, si dy pole që gjenerojnë fshehtësinë, adrenalinën apo më saktë urinën e kushtëzuar për kureshtjen e rrëfimit. Në të dyja rastet spikat rezistenca e brendshme për të mos iu nënshtruar makinës shtypëse e rrafshuese të nivelimit të personalitetit.

Ahmetaj na mban pezull me "artin e kopracisë" së rrëfimit, fshehjes apo më mire, shtyrjes së faktit intrigues, duke ruajtur deri në faqet e fundit shtjellimin e plotë të enigmës. Midis poetizimit, blasfemisë dhe anatemes, romani është sa thriller politik, dedektiv, aq dhe elegji për Kohën dhe metamorfozën që ajo bën me njeriun, brezin, idealet.

Në roman ka nota autobiografike, disa herë të theksuara; ka përsëritje të fshehta për shumë miq të tij e ngjarje të zëshme në kapërcyell të viteve '80. Por kryesisht "Procesi...." i Ahmetajt është, më së pari, një roman fiction, një produkt i imagjinatës. Romani është një homazh dhe postscriptum njëherësh i asaj që ne donim, ëndëronim dhe meritonim të ishim dhe asaj, që të gjithë e kemi peng dhe e perjetojmë si "prerje në besë".

Toni dhe intonacioni familjar e mirëbesues i rrëfimit të ngjitet dhe vijon shtruar, si me "gisht ndër buzë", për sekrete që priten të hapen, pa artifica e patetikë, aq sa fshihet/shuhet pa ndjerë kufiri që të bën me dije, se ti po lexon një vepër artistike. Thjesht të ka rrëmbyer Jeta e njëmendet dhe ti je përpirë brenda saj. Kjo për mua është shenja e një pjekurie të lartë dhe tregues i një cilësie të padiskutueshme për një prozë të bukur dhe prozator të mençur.

E falenderoj autorin për këtë roman, sa të dobishëm, aq dhe prekës me artin e "padhunë" që na përcjell

\*\*\*

Arbër Ahmetaj është shkrimtari që jeton prej dy dekadash jashtë Shqipërisë. Ai detyrën që i takon një shkrimtari (të shkruaj sa më mirë të mundet), e ka kryer dhe vazhdon ta kryejë bindshëm. Ç'të bëjë më shumë se kaq? Po për mendimin tim lexuesit, propaganduesit e librit, seleksionuesit profesionistë të vlerave letrare (ndonëse të paguar nga shteti), i kanë hyrë në hak prozës romanore të shkrimtarit Arbër Ahmetajt!

## Per romanin Nje nate tek Luiza, te autorit Arbër Ahmetaj

*Sulejman Dida, Kukës, 11.11.2015*

Mbasi lexova me një frymë këtë prozë elegante, nuk e di pse më bën të them, kështu foli Arbër Ahmetaj. Të duket se e dëgjon nistoren e mbiemrit, ah, të mbetur pezull në ajër, teksa ndjek rrëfimet plot bukuri të episodeve të fëminisë dhe ato të mëvonshmet e rinisë, pa pasë bjerrje nga sinqeriteti magjepsës e deri te tregimet mëvonëshme me plot paradokse e ironi ballkanike. Deri tek ato mëkatet e bukura mes burrit dhe gruas. Një roman i ndërtuar në formën e rrëfimit të prozave të shkurta, të kaluara me përpikmëri e pa gabime nga bashkëbiseduesja Luizë, e cila jep edhe komente. Shpalsja e krejt ngjarjeve që përbjnë romanin, episode të publikuara ose të paktën të fiksuara në një tekst, ndodh në një natë të vetme, në të cilën autorit nuk i mbetet veçse të pophojë ndonjë detaj ose thjesht të ndjekë i ftohtë filmin e jetën e vet me nje gotë venë përpara. Episodi i fillimit titullohet 'Fqinja përvëluese' e vendosur ndoshta si një intrigë përvëluese për ta motivuar Luizën të ecë në gjurmët që vetë autori i ka shtruar për të mbërritur deri në fund të krejt prozave po ashtu përvëluese. Më pas vijnë tri skica ndër të cilat ajo me titull 'Ne, polici, bima' që rrëfen kolizionin natyror. Që rrëfen metamorfozën e çuditshme, sepse në sistemin dhe komunitetin e asaj kohe, e vetmja mënyrë për të shpëtuar adn-ja e dashurisë ishte shndërrimi në një bime. Produkti i dashurisë nuk pranohet nga opinioni. Vetë opinioni, dmth, komuniteti, (ajo çka mendonin njerëzit) është tjetërsuar prej origjine. Është armiqsuar me kujtesën e vet fizike për shkak se i është nënshtruar presionit antinatyror, dmth antinjeri dhe mënyra e ruajtjes nga sulmet vrasëse për krijesën është shndërrimi në bimë. Fantazia e autorit shkon larg deri në piktakimin me mitologjinë popullore.

Luiza, mikpritëse dhe bashkëbiseduese e autorit, ashtu si mjeku me përvojë vëzhgon grafinë e plagës së vjetër, në rastin tonë të brengës së vjetër, fiksuar në frekuencë të sekondës, krejt e ftohtë lexon historitë e shkruara. Ajo nuk habitet edhe ku mëson se sistemi komunist në Shqipëri si një makineri vrasëse, u kujdes që jo vetëm ta zhveshë personin dhe turmën nga çdo përmbajtje a tendencë lirie, por kishte platformë edhe për letërsinë, për përkthimin në gjuhë të huaj, psh, ku në bazë të kriterëve joletrare përcaktohej se kush duhej trajtuar si shkrimtar i madh apo i shquar dhe kush duhej trajtuar si armik. Autori na kujton faktin që ne ishim të rrethuar, ndër të tjera, edhe nga një letërsi vrasëse e lirisë. Luiza thjesht jep mendim për anën artistike të tekstit, e, më shumë se personazh shërben si një 'mjet' lidhës. Në fund të fundit, kush mund ta 'egzaminojë' shpirtin e burrit përveçse një grua? Romani mbyllet me tregimin 'perla e alpeve' për të cilën çdo fjalë lavdëruese do të ishte e pakët. Krejt libri 'Një natë tek Luiza' përbën një pohim ekzistence. Një shkrimje episodesh jetësore mes sinqeritetit fëminor dhe mjeshtrisë së sintaksës, mes mençurisë së dijetarit dhe elegancës gati folklorike të rrëfimit. Në këtë prozë ndërthuren realizmi magjik me akzistencializmin.

Ndër të tjera bien në sy edhe plot fjalë të bukura të shqipes që autori i sjell si forma të reja e si fjalformime, stilema me të cilat ka pikturuar natyrën apo profilin e njeriut: hihet e bungjeve, rrufe idhnake, burrë i hëntë, flokhënti, profil qengji, prehje e neontë, qëllim imcak, zërritësat, margarinë e kërmilltë, qiell i pikëllimtë, i gëlqertë, një imtë dobësie, prushurohet etj.etj. Le ta mbyllim me penelatën e shkëlqyer ku përshkruhet peziashi alpin por edhe energjia dhe joshja e burrit dhe gruas: hëna kishte dalë për gjah majeve të maleve me dëborë. (138-39).